

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 6977/24

EDMOND PANAHORI KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 17 mars 2026, si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetare*,

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit*,

Në lidhje me:

kërkesën (nr. 6977/24) kundër Republikës së Shqipërisë, të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 1 mars 2024 nga një shtetas shqiptar, z. Edmond Panahori (“kërkuesi”), i cili ka lindur në vitin 1974, është i burgosur në Fier dhe u përfaqësua nga z. A. Syri, një avokat i cili e ushtron profesionin në Berat;

vendimin për të njoftuar mbi kërkesën qeverinë shqiptare (“Qeveria”), përfaqësuar nga Agjenti i saj, z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

konstatimet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me procedurat penale ndaj kërkuesit. Kërkuesi u ankua për mungesë të aksesit në Gjykatën Kushtetuese dhe pamundësinë e tij për të marrë pjesë në procedurat pranë Gjykatës së Lartë.

2. Më 19 nëntor 2013, pas procedurave të përshpejtuara, Gjykata e Rrethit Fier e dënoi kërkuesin me dhjetë vjet burgim për vrasje. Në apel, ai vendim u reduktua në gjashtë vjet dhe gjashtë muaj nga Gjykata e Apelit Vlorë. Më 12 mars 2015, Prokuroria e Vlorës paraqiti një apelim pranë Gjykatës së Lartë me argumentin se dënimi i dhënë ishte shumë i butë.

3. Më 27 mars 2015, kërkuesi, i cili ishte në burgim në atë kohë, u njoh me apelin e prokurorisë.

4. Më 19 maj 2015, Gjykata e Lartë e shpalli apelin e prokurorisë të pranueshëm.

5. Në vitin 2017, kërkuesi e përfundoi vuajtjen e dënimit të tij në Shqipëri dhe më 13 maj 2017 u zhvendos në Itali.

6. Gjykata e Lartë e dërgoi njoftimin e datës se kur do të vlerësohej çështja e kërkuesit në burgun ku ai kishte vuajtur dënimin. Autoritetet e burgut e informuan Gjykatën e Lartë se kërkuesi e kishte përfunduar dënimin e tij dhe nuk ishte më në atë burg. Më pas, Gjykata e Lartë e dërgoi njoftimin në adresën e shtëpisë së kërkuesit në fshatin Mbres. Megjithatë, njoftimi nuk iu dha kërkuesit, sepse ai nuk jetonte më atje.

7. Gjykata e Lartë caktoi një avokat që ta përfaqësonte kërkuesin dhe gjykoi çështjen në mungesë të kërkuesit. Më 26 korrik 2021, Gjykata e Lartë e prishi vendimin e apelit dhe la në fuqi vendimin e shkallës së parë. Ky vendim u publikua në faqen e saj të internetit më 9 nëntor 2021.

8. Me kthimin e tij në Shqipëri më 7 maj 2023, kërkuesi u arrestua menjëherë dhe u njoh me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 26 korrik 2021.

9. Më 31 gusht 2023, kërkuesi paraqiti një ankesë kushtetuese me argumentin se ai kishte mësuar për vendimin e kontestuar të Gjykatës së Lartë më 7 maj 2023.

10. Më 25 tetor 2023, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankesën kushtetuese të kërkuesit të papranueshme, pasi ishte paraqitur jashtë afatit katërmujor, duke nisur llogaritjen që prej datës

9 nëntor 2021. Gjykata Kushtetuese gjykoi se më 27 mars 2015, kërkuesi ishte njohur me ankesën e prokurorisë bërë në Gjykatën e Lartë dhe, për këtë arsye, kërkuesi kishte detyrimin të ndiqte ecurinë e çështjes së tij pranë Gjykatës së Lartë dhe të kërkonte informacion për të. Gjykata Kushtetuese nuk e pranoi pretendimin e kërkuesit se ai kishte mësuar për vendimin e Gjykatës së Lartë më 7 maj 2023, si provë të mjaftueshme se me të vërtetë ai ishte vënë në dijeni për gjykimin e kontestuar në atë datë.

VLERËSIMI I GJYKATËS

Neni 6 § 1 i Konventës

1. Aksesit në Gjykatën Kushtetuese

11. Kërkuesi u ankua për shkelje të së drejtës së tij për t'iu drejtuar një gjykate, duke iu referuar përllogaritjes së Gjykatës Kushtetuese të afatit kohor për paraqitjen e një ankese kushtetuese.

12. Gjykata ka shqyrtuar çështjen e aksesit në Gjykatën Kushtetuese, për shkak të përllogaritjes së afatit katërmujor në *Supergrav Albania sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 20702/18, 9 maj 2023.

13. Duke u kthyer në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi u vu në dijeni të apelimit të prokurorisë në Gjykatën e Lartë më 27 mars 2015 (shih paragrafin 3 më sipër), dhe për këtë arsye kishte dijeni se proceset e Gjykatës së Lartë ishin pezull pranë kësaj gjykate. Megjithatë, kur kërkuesi u lirua nga burgu në vitin 2017, ai nuk pyeti për çështjen e tij pranë Gjykatës së Lartë dhe as nuk i dha Gjykatës së Lartë adresën e tij të re. Për këtë arsye, Gjykata e Lartë dërgoi fletëthirrje fillimisht në burg, dhe më pas në fshatin Mbres, në të vetmen adresë që kishte për kërkuesin në dosje.

14. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se, arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese që e shpall të papranueshme ankesën kushtetuese të kërkuesit dhe përllogarit afatin nga data e vendimit të Gjykatës së lartë, nuk mund të shihet si arbitrar. Gjykata Kushtetuese vlerëson me të drejtë se duke qenë se kërkuesi kishte qenë në dijeni të procedurave pezull pranë Gjykatës së Lartë, ishte detyra e tij që të ndiqte ecurinë e këtyre procedurave, ose të paktën të paraqiste adresën e tij të përditësuar pranë Gjykatës së Lartë për njoftime të mëtejshme.

15. Mbështetur në sa më sipër, kërkuesi nuk veptoi me kujdesin e duhur të kërkuar për t'i bërë të mundur Gjykatës së Lartë që t'i dërgonte atij fletëthirrjet dhe vendimin e formës së prerë. Për këtë arsye, interpretimi i Gjykatës Kushtetuese për rregullat procedurale të zbatueshme në çështjen konkrete përbente një kufizim proporcional të së drejtës së kërkuesit për t'iu drejtuar një gjykate, gjë që nuk cenonte thelbin e asaj të drejte (shih *Johansen kundër Gjermanisë* nr. 17914/10, §§ 46-57, 15 shtator 2016).

16. Për rrjedhojë, kjo ankesë është qartazi e pambështetur dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

2. E drejta e kërkuesit për të marrë pjesë në procedurat pranë Gjykatës së Lartë

17. Kërkuesi u ankua edhe se ishte shkelur e drejta e tij për të marrë pjesë në procedurat pranë Gjykatës së Lartë dhe e drejta e tij për t'u njoftuar për vendimin e tij.

18. Gjykata ka pranuar arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese, duke e shpallur të papranueshme ankesën kushtetuese të kërkuesit. Rrjedhimisht, të gjitha ankesat e tjera që kërkuesi ka ngritur janë të papranueshme për mosshkrim të mjeteve vendëse, pasi kërkuesi nuk respektoi rregullat proceduralë për paraqitjen e një ankese kushtetuese.

19. Në këtë mënyrë, kjo pjesë e kërkesës duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshkrim të mjeteve vendëse.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 9 prill 2026.

Olga Chernishova
ZËVENDËSSEKRETARE

Úna Ní Raifeartaigh
KRYETARE